



A.nr. 2073/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr. 2073/2025, të datës 26.12.2025, të parashtruar nga ankuesja N.B. nga Prishtina, në çështjen juridike – administrative “*kundërshtim të masës disiplinore*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 10.06.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr. 2073/2025, e datës 26.12.2025, e parashtruar nga ankuesja N.B.

II. Anulohet masa disiplinore “Paralajmërim me shkrim” e shqiptuar ndaj ankuses përmes shkresës së datës 12.12.2025, të Udhëheqësit të Divizionit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme në kuadër të Agjencisë për Forenzikë.

III. Obligohet Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë për Forenzikë që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimit, të largoj nga dosja personale e ankuses masën disiplinore të anuluar si në pikën II të dispozitivit.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra.

A r s y e t i m

Ankuesja N.B. (*tutje referuar ankuesja*), më datë 26.12.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër masës disiplinore “Paralajmërim me shkrim”, të datës 12.12.2025, të shqiptuar nga Udhëheqësi i Divizionit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme në Agjencinë e Kosovës për Forenzikë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje referuar vetëm Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Agjencinë e Kosovës për Forenzikë, ndërsa, kjo e fundit, ka përcjellë shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 8078/2025 të datës 26.12.2025 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin A.nr.1481/2024 të KPMSHCK-së; Kërkesën për rishqyrtim të ekuivalentimit të koeficienteve për Ekspertët e IT në AKF datës 03.02.2025 të dërguar nga ankuesja për DMZP; Emailin e datës 26.02.2025 nga ankuesja për B.K, Sh.G, B.Sh, B.A, B.H; Emailin e datës 12.02.2025 nga DMZP për ankuesen; Paralajmërimin me shkrim të datës 12.12.2025; Emailin e datës 24.11.2025 nga ankuesja për Drejtorin e DMZP; Emailin e datës 26.11.2025 nga Drejtori i DMZP për ankuesen; Vendimin me Nr.Protokolli: AKF-139/2025 i datës 12.11.2025 i Komisionit Disiplinor të AKF-së; Vendimin A.nr.1872/2025 të KPMSHCK-së; Kopjen e ID-së së ankueses; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 08.01.2026; Përgjigjen në ankesë e datës 14.01.2026; Vendimin e datës 21.03.2024 për transferim të përhershëm të ankueses; Ankesën e datës 28.02.2025 nga H.M për B.K; Emailin e datës 14.08.2025 nga B.K për Sh.D; Emailin e datës 19.08.2025 nga Sh.D për H.K; Emailin e datës 22.08.2025 nga H.K për kryesuesin e Komisionit Disiplinor; Emailin e datës 17.09.2025 nga kryesuesi i Komisionit Disiplinor për ankuesen; Procesverbalin e takimeve datës 17.09.2025 të Komisionit Disiplinore; Kërkesën për përcaktimin e zyrtarëve si ekspert të forenzikës së TI-së e datës 23.04.2025.

Kolegji i Këshillit, duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç, dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa është e bazuar, sepse:

Gjendja e fakteve

Nga administrimi i provave materiale rezulton:

- Ankuesja sipas Vendimit me Nr.Prot: AKF/2024-38 të datës 21.03.2024, ushtron pozitën Zyrtare e Burimeve Njerëzore në Divizionit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme, në Agjencinë e Kosovës për Forenzikë.

-Zyrtarja e Agjencisë së Kosovës për Forenzikë, znj. H.M, më datë 28.02.2025 ka adresuar një ankesë ndaj ankueses duke pretenduar se e njëjta nuk ka dërguar dosjen e saj në DMZP sipas Vendimit A.nr.1481/2024 të KPMSHCK-së, me arsyetimin se nuk ka vendim për Ekspert Forenzikë dhe se ankesa në fjalë është përcjell tek kryesuesi i Komisionit Disiplinor më datë 22.08.2025.

- Komisioni Disiplinor i Agjencisë së Kosovës për Forenzikë më Vendimin Nr.Prot:AKF-139/2025, të datës 12.11.2025, ka vendosura që lënda të bartet tek mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankueses me arsyetimin se nuk janë shkaktar pasoja dhe se efekti juridik arrihet edhe me shqiptimin e masave të lehta.

-Udhëheqësi i Divizionit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme në zbatim të vendimit të Komisionit Disiplinor më datë 12.12.2025 ka shqiptuar ndaj ankueses masën disiplinore “Paralajmërim me Shkrim”.

Pretendimet ankimore

Ankuesja, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundërshton masën disiplinore “paralajmërim me shkrim” të datës 12.12.2025, duke pretenduar se pas pranimit të Vendimit Anr.1481/2024 të KOMSHCK-së, me qëllim të kompletimit të lëndës për të përcjell në DMZP, ka kërkuar vendimet për ekspert forenzikë, ndërsa, u.d Kryeshefi Ekzekutiv ka njoftuar se znj. H.M nuk posedon vendim për ekspert forenzikë dhe me udhëzimin e tij lënda e H.M është larguar nga shkresa e cila më pas është nënshkruar dhe dërguar në DMZP. Tutje, pretendon se veprimet e saj kanë

qenë në pajtim me vendimin e KPMSHCK-së; udhëzimin e u.d Kryeshefit Ekzekutiv dhe Ligjit për Pagat lidhur me kushtet për koeficientin 14, kështu që, nuk kam bërë asnjë tejkallim të kompetencave.

Vlerësimi i Kolegjit

Kolegji i Këshillit për vendosje të drejtë dhe meritore lidhur me çështjen ankimore, iu referua Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, me theks të veçantë:

- Nenit 55 paragrafi 1: *“Nëpunësja/i civil mban përgjegjësi disiplinore për shkelje të detyrave dhe përgjegjësi, në rastet kur nuk kryen detyrat që i janë dhënë, kur bën zbatim jo të duhur të tyre apo kur gjatë ushtrimit të tyre vepron në kundërshtim me Kushtetutën, ligjet dhe aktet e tjera nënligjore në fuqi. Shkelja disiplinore mund të bëhet me veprim apo mosveprim”.*
- Neni 56, paragrafi 1 dhe 3: *“Shkeljet e detyrave dhe përgjegjësi të punës mund të jenë: 1.1. shkelje të lehta; 1.2. shkelje të rënda. 3. Shkelje të lehta konsiderohen: 3.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune radhazi; 3.2. mosrespektimi i orarit të punës; 3.3. sjellja jo e mirë gjatë kohës së punës, me mbikëqyrëset/it, koleget/ët, vartëset/it dhe me publikun.*
- Nenit 57 paragrafi 1: *“1. Masat disiplinore, të cilat mund të shqiptohen ndaj nëpunës/it civil për shkelje të lehta janë: 1.1. vërejtje verbale; 1.2. paralajmërim me shkrim; 1.3. vërejtje me shkrim”.*

Kolegji i Këshillit referuar bazë ligjore si më lartë ka shqyrtuar aktin e kontestuar më ankesë në ndërlidhje më provat materiale të çështjes dhe si rrjedhojë ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më Vendimin A.nr.1481/2024 të datës 31.12.2024 kishte aprovuar ankesën e datës 03.10.2024 të ankuesve B.K, B.A, B.Sh, B.H, Sh.G-F dhe H.M, që të gjithë zyrtarë të Agjencisë për Forenzikë, duke obliguar Njësinë e Burimeve Njerëzore të Agjencisë për Forenzikë që rastin e ankuesve t'a dërgoj për rishqyrtim të ekujalentimit të koeficienteve në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë.

Rrjedhimisht, sipas obligimeve të dalura nga Vendimi A.nr.1481/2024 të KPMSHCK-së, ankuesja ka ndërmarr veprime, ashtu që, njëjta më datë 03.02.2025 ka dërguar rastin e palëve (me përjashtim të palës H.M pasi që sipas thënieve në ankesë e njëjta ishte larguar më udhëzime të udhëzimit të Drejtorit të Përgjithshëm) në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, ndërsa, ky i fundit, më datë 12.02.2025 kishte njoftuar ankuesen se nuk ka kompetencë ligjore të trajtoj kërkesën e datës 03.02.2025. Pas, kësaj, më datë 23.04.2025, institucioni ka përcjell pranë Komisionit për Ekspertë përfshirjen në listën e ekspertëve të gjithë zyrtarëve si palë në Vendimin A.nr.1481/2024, të KPMSHCK-së, përfshirë edhe zyrtaren H.M.

Rrjedhimisht, masa disiplinore “Paralajmërim me Shkrim” e shqiptuar ndaj ankueses më datë 12.12.2025, është bazuar vetëm në Vendimin Nr.Protokoll:AKF-139/2025 të datës 12.11.2025, të Komisionit Disiplinor të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë, pa ndonjë cilësim të shkeljes disiplinore dhe konstatim të shkeljes, gjegjësisht, shqiptuesi i masës fare nuk ka saktësuar se cilat veprime apo mos veprime të ankueses përbejnë shkelje disiplinore të lehtë. Në fakt, në vlerësimin e Kolegjit qëndron fakti që ankuesja nuk ka përcjell në DMZP-së dosjen e zyrtares H.M ashtu siç ishte detyruar nga KPMSHCK-ja me vendimin A.nr.1481/2024, mirëpo, nga kjo mos përfshirje zyrtarja H.M nuk ka pasuar ndonjë dëm material, sepse, DMZP-ja nuk ka marr ndonjë vendim meritore lidhur më çështjen, fakt ky i konfirmuar edhe nga vet Komisioni Disiplinor i Agjencisë për Forenzikë, kështu që, mbi këto rrethana nuk mund të argumentohet se në veprimet e ankueses manifestohen elemente të shkeljes së lehtë disiplinore.

Bazuar në rrethanat si më lartë, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, gjegjësisht aprovoj ankesën e ankueses si të bazuar, anuloi masën disiplinore ” paralajmërim me shkrim’ të datës 12.12.2025, dhe obligoj Drejtorin Ekzekutiv të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë që sipas dispozitivit dhe arsytimit të këtij vendimi të ndërmerr të gjitha veprimet që masa disiplinore e shqiptuar ndaj ankueses të largohet nga dosja personale e saj.

Këshillë juridike: Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

A.nr.2073/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses N.B;
- Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.